



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 77
Prishtinë, më 17 shtator 2012

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR
MË 17 SHTATOR 2012**

Mbledhjen e kryesoi kryetari **Jakup KRASNIQI**, ndërsa i ndihmoi nënkryetari **Xhavit HALITI**.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Halit Krasniqi, Alma Lama, Emilija Rexhepi, Fadil Demaku, Xhevahire Izmaqi dhe Ganimete Musliu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Visar Ymeri parashtoi pyetje për ministrin Fehmi Muja, në lidhje me rritjen e çmimit mesatar për kilometër të autostradës Vërmicë-Merdar.

Ministri Fehmi Muja iu përgjigj pyetjes së deputetit Visar Ymeri.

Deputeti Visar Ymeri parashtoi pyetje për ministrin Besim Beqaj, në lidhje me faktin se sa para Kosova i ka paguar Serbisë për përdorimin e kodit telefonik +381 dhe sa para i janë paguar Monakos për përdorimin e kodit telefonik +377.

Ministri Besim Beqaj nuk ishte i pranishëm.

Deputetja Hykmete Bajrami parashtoi pyetje për ministrin e Drejtësisë, Hajredin Kuçi, në lidhje me mundësinë që ligjet, të cilat e plotësojnë dhe e ndryshojnë një ligj tjetër, të vijnë në një dokument të vetëm, e jo ta kemi ligjin e ndarë në disa pjesë.

Ministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm.

* * *

Në vazhdim të punimeve të Kuvendit, Adem Grabovci, në emër të GP të PDK-së, propozoi që nga rendi i ditës së mbledhjes së sotme plenare të hiqet pika - **Debat parlamentar lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë**, me arsyetim se shumica e anëtarëve të Kabinetit qeveritar gjendet në udhëtime zyrtare.

Kryesuesi kërkoi deklaratimet e përfaqësuesve të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e lartshënuar.

Në lidhje me propozimin e deputetit Adem Grabovci u deklaruan: Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Sasha Milosavljeviq - në emër të Grupit Parlamentar SLS, Myfera Shinik - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe deputetët Sabri Hamiti dhe Muhamet Mustafa, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e kryetarit të GP të PDK-së.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 44,
Kundër ----- 41,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash vendosi që debati parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, mbështetur edhe nga gjashtë deputetë të tjerë lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë, të shtyhet për një mbledhje tjetër.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2011,
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2011,
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2011

Kryesuesi e ftoi Avokatin e Popullit që para Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Raportin vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2011.

Avokati i Popullit, Sami Kurteshi, tha se në bazë të nenit 135, paragrafi 1 dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 27 të Ligjit për Avokatin e Popullit, para deputetëve të Kuvendit do të paraqesë raport vjetor për punën e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Raporti në fjalë i pasqyron aktivitetet e Institucionit të Avokatit të Popullit për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2011, për të konstatuar se çështja e të drejtave të njeriut në Kosovë është tema kryesore, të cilën e trajton ky raport.

Në vazhdim, ai e vlerësoi çështjen e të drejtave të njeriut në Kosovë si të tillë që ka nevojë për shumë përparim dhe këtë e cilësoi si mjaft të brishtë, e të tillë e bëjnë besimi i humbur në shtetin ligjor, drejtësia përzgjedhëse në Kosovë, mungesa e ndërgjegjes së një pjese të institucioneve shtetërore, fakte këto të cilat po shkaktojnë përkeqësim në raportet ndërnjerëzore dhe ndërshtetërore.

Më tej, ai tha se Avokati i Popullit jep vazhdimisht rekomandime për zgjidhjen e shumë problemeve me të cilat ballafaqohet një pjesë e qytetarëve të vendit, por fatkeqësisht këto rekomandime nuk zbatohen në praktikë nga institucionet e ndryshme, prandaj kjo është një çështje mjaft shqetësuese. Po ashtu, shqetësuese është edhe mospërfillja e institucioneve të caktuara shtetërore dhe injorimi që u bëhet institucioneve të pavarura në vend, duke theksuar se një gjë e tillë po e përcjell edhe Institucionin e Avokatit të Popullit.

Me qëllim të rritjes së transparencës, Institucioni i Avokatit të Popullit, çdo kërkesë që na adresohet, i përgjigjemi në formë të shkruar, theksoi ai.

Më pas, ai u fokusua në të dhënat statistikore të raportit që kanë të bëjnë me numrin e rasteve të paraqitura, të proceduara dhe të zgjidhura gjatë vitit 2011, ndërsa duke folur për shkaqet e ankesave të qytetarëve, ai i përmendi disa nga ato që kanë të bëjnë me pensionet, sigurimet shëndetësore, mungesën e barnave nga e ashtuquajtura “listë esenciale”, të drejtën e pronës dhe gjendjen mjedisore.

Duke folur për lirinë e lëvizjes në Kosovë, ai theksoi se në tri komunat veriore të Kosovës: Leposaviq, Zubin-Potok dhe Zveçan, kjo është gati e pamundur, ndërsa edhe siguria fizike e pjesëtarëve të nacionalitetit joserb në atë pjesë është e rrezikuar.

Në fund, ai kërkoi nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që ta miratojë Ligjin për sigurimet pensionale dhe invalidore, si dhe Ligjin për sigurimet shëndetësore. Diskutimi i plotë i Avokatit të Popullit është dhënë në transkript.

Kryesuesi e hapi debatin për Raportin vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2011.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadërgjonaj - në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Kurtan Kajtazi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Rita Hajzeraj-Beqaj - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albana Gashi - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Kymete Bajraktari - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Amir Ahmeti - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Goran Marinković - në emër të Grupit Parlamentar SLS, Albert Kinolli - në emër të Grupit

Parlamentar “6+”, si dhe Arsim Bajrami, Donika Kadaj-Bujupi, Hykmete Bajrami, Vjollca Krasniqi, Gëzim Kelmendi, Fatmir Limaj, Haki Demolli, Vjosa Osmani, Alma Lama, Eqrem Kryeziu, Hashim Dëshishku dhe ministri Bedri Hamza, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 67,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Raportin vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2011.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2011

Deputetja Safete Hadërgjonaj, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, tha se si në këtë komision është shqyrtuar Raporti vjetor i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2011 dhe është rekomanduar shqyrtimi dhe miratimi në mbledhje plenare.

Ajo në fund e përkrahu Raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2011.

Gjithashtu, edhe deputeti Ali Sadriu, në emër të Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, tha se si komision e kanë shqyrtuar Raportin vjetor dhe pasqyrat e audituara financiare të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2011 dhe kanë rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Hasime Krasniqi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hykmete Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albana Fetoshi - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Xhevdet Neziraj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Hashim Dëshishku, Albana Gashi, Hykmete Bajrami dhe ministri Bedri Hamza, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 59,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2011.

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të performancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011

Deputeti Ali Sadriu, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrje të Financave Publike, tha se si komision e kanë shqyrtuar Raportin vjetor të performancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011 dhe kanë rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai në fund e përkrahu Raportin vjetor të performancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Valbona Dibra - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ali Sadriu - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Afrim Hoti - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Bali Muharremaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Albert Kinolli - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Hashim Deshishku dhe Salih Morina, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për procedimin me votim e kësaj pike. Votimi i Raportit vjetor të performancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011 shtyhet për mbledhjen plenare të radhës.

* * *

Kryesuesi i deklaroi të mbyllura punimet e mbledhjes plenare në orën 15:56 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale